



FOTO: FATKEQËSITË NATYRORE NUK NJOHIN KUFINJ

PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal
i Zi - Kosovë 2014- 2020

Gusht 2019

PËRMBAJTJA

Edicioni i pestë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë* 2014-2020.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- »»» Bashkpunimi ndërkufitar si një mjet për zhvillimin rajonal dhe sinergjinë ndërmjet sektorëve2
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....3
- »»» Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....6
- »»» Takimi i tetë Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Plavë8

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Башкимит Европјан
параете домодохмерисит менидмет е



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE – ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



MNE – KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020



Bashkpunimi ndërkufitar si një mjet për zhvillimin rajonal dhe sinergjinë ndërmjet sektorëve

Projekti "Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyrorë tërheqës" po zbatohet nga Agjencia për zhvillimin rajonal – West (RDA-West) nga Kosova dhe Agjencia e zhvillimit Rajonal Bjelasica, Komovi and Prokletije (RDA BKP) dhe synon të mbështesë zhvillimin e zonës ndërkufitare të bjeshkëve të Nemuna si një destinacion turistik natyrorë. Të dy AZHR-të janë të mendimit që programi ndërkufitar është shumë i rëndësishëm pasi kontribuon në përbushjen e vizionit dhe qëllimeve të organizatave respektive, të cilat janë zbatimimi i projekteve cilësore që mundësojnë zhvillimin e balancuar të rajonit perëndimor të Kosovës dhe rajonit verior të Malit të Zi.



Partneri i tyre në projekt, KOMuna e Pejës, e konsideron programin të rëndësishëm për përbushjen e qëllimeve strategjike të Komunës, pasi jep mundësi që të zbatohet projekte të cilat nuk do ishin të mundur për shkak të burimeve të kufizuara Brenda buxhetit të komunës. Bashkpunimi ndërkufitar ka mundësuar krijimin e sinergjive të shumëfishta ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile, përfaqësuesit e të cilëve janë bashkuar për zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe iniciativave që ndihmojnë zhvillimin e komunës në mënyra të ndryshme. Nga ana tjetër Organizata turistike e Plavës vë theksin tek zhvillimi i ofertës ndërkufitare, që mundeson projektin, e cila është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të kësaj komune të vogël, si një nga komunat më pak të zhvilluara në vend.



Aktivitetet e para të këtij projekti u zhvilluan në Kosovë. Për të gjithë partnerët në projekt është përfitim i madh të ndajnë informacion, njohuritë dhe aftësitë me homologët e tyre nga vendet fqinjë dhe kjo ka qënë një eksperience majft domethënëse, jo vetëm gjatë periudhës së shkrimit të projekt propozimit por edhe gjatë zbatimit të tij. Shkëmbimi i eksperiencës na ka ndihmuar të identifikojmë edhe shumë fusha të tjera ku mund të shtrihet bashkpunimi. Projektet e zbatuara në kuader të thirrjeve të mëparshme mund të replikohen lehtësisht në vendet fqinje. Si përfundim, mundësia për të punuar bashkë ka krijuar një platformë për bashkpunim në të ardhmen që do shkojë përtej programit ndërkufitar. Ndërkohë, përfituesit final mendojnë se projekti do ketë ndikim në



zhvillimin e turizmit në zonë dhe do kontribuojë në rritjen e mundësive për të gjithë ata që punojnë në fushën e turizmit, aventurës, sporteve dhe rekreacionit në natyrë.

Ne e ndjejmë që kontributi ynë është i vlerësuar dhe merret në konsideratë gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit edhe në fazën e procedurave për blerjen e pajisjeve dhe materialve që do përdoren për projektin dhe pas tij, tha Nol Krasniqi nga OJQ "Marimangat" një organizatë që promovon dhe organizon ngjitjet malore dhe sportet e aventurës.



Bukurite natyrore që ofrojnë malet e zonës dhe kultura e trashëgimia e përbashkët ndërmjet njerezve janë një vlerë e shtuar për

të gjithë dhe veçanërisht për ato që vizitojnë këto zona si



turistë, tha Raif Gjickolli nga shoqata e alpinistëve "Gjeravica".

Fakti që kërkesa për shërbimet e lidhura me turizmin rritet, ndoshta do të bëjë që strukturat e programit ndërkufitar të mbajnë në konsideratë gjatë hartimit të skemave të granteve dhe thirrjeve për projekte, duke theksuar më fort mundësinë e nën-granteve. Kjo do ishte me shumë interes për operatorët e vegjël, bizneset akomoduese dhe shoqatat e tjera si dhe për vet familjet që jetojnë në këto zona të cilat kanë interes të bëhen pjesë e industrisë së turizmit.

Arian Harxhi nga OJQ "BSF/BPK" një shoqatë e çiklistëve malore nga Kosova, deklaron që projekti ka dhënë një incentivë shtesë për të gjithë që të punojnë sëbashku dhe kjo mundësi për të ndarë njohuritë dhe eksperiencat do mundësojë që të ketë zhvillim në të dy anët, duke krijuar rrjetin e organizatave dhe individëve që kanë vlera dhe qëllime të përbashkëta.

Virtyt Gacaferri nga kompania e udhëtimeve Balkan Natural Adventure është i mendimit që duke gjykuar nga rezultatet e arritura deri tani, projekti do krijoj produkte dhe rezultate që do kenë



ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e turizmit të zonës dhe do krijojë mundësi të reja për të gjithë ata që punojnë në fushën e turizmit, sportive të aventurës dhe rekreacionit natyrorë.

Te reja nga projektet e financuara ne thirrjen e I-re te programit IPA BNK Mal i Zi -Shqipëri

Vizite studimore ne Jugun e Shqipërise, trajnime dhe Panairi 2019

Në kuadër të projektit "Pjesa Femërore e Cilësisë" gjatë muajit Maj të vitit 2019, qendra UET në bashkpunim me Bashkinë Mirditë, Komunen e Ulqinit dhe OJQ MogUl organizuan një vizitë të përbashkët studimore në Shqipëri me gratë pjesëmarrëse në projekt nga të dy anët e kufirit. Vizita u bë në qytetin e Përmetit dhe Gjirokastrës, dhe ishte e lidhur me produktet lokale dhe promovimin e tyre.



Gjithashtu gjatë këtij muaji, OJQ Monitoring group Ulcinj-MogUl përfundoi sesionet e trajnimeve edukuese të konceptuara për gratë nga zonat rurale të Ulqinit. Nga ana tjetër Qendra UET në bashkpunim me Bashkinë Mirditë organizuan një tjetër sesion të trajnimeve edukuese për gratë e rajonit të Mirditës. Trajnimet ishin të fokusuar në temën "Ushqimi i Sigurtë" dhe "Vlerësimi i Performancës Financiare".



Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti, u organizua "Panairi Festiv 2019" në periudhën nga 16 – 18 gusht të vitit 2019, gjatë të cilit gratë nga zonat rurale të Ulqinit patën mundësi të promovojnë produktet e tyre shtëpiake dhe aftësitë e përfituara nga trajnimet e projektit. Ceremonia hapëse e panairit u mbajt me dt 16 gusht të vitit 2019, tek shetitorja Rana



(Pristan) në Ulqin, gjatë të cilës morën pjesë dhe pershendetën të pranishmit Kryetari i Komunës së Ulqinit Z.Loro Nrekic, Znj. Zana Sarvan nga Organizata Turistike e Ulqinit, Z.Armend Milla nga Ministria e Turizmit dhe Z. Almir Çausheviq nga SPT-ja. Pjesëmarrësit patën mundësinë të shijonin një program të pasur kulturorë dhe artistik shoqëruar me produktet lokale të përgatitura nga gratë sipërmarrëse. Panairi u vizitua nga afërsisht 3000 persona.



Kushte më të mira pune për Kompaninë e Mirëmbatjes në komunën e Beranes dhe bashkinë Malësi e Madhe

Në kuadër të projektit "Ishuj të Gjellbërt", një makineri e re për mbledhjen e mbeturinave u prokurua për Kompaninë e Mirëmbatjes në komunën e Beranes. Edhe në Shqipëri, Ndërmarrja e Mirëmbatjes dhe Shërbimeve të Bashkisë Malësi e Madhe do të pajiset së shpejti me një mjet për mbledhjen e mbeturinave.



Për më tepër, në 26 Korrik, u organizua në Berane ligjerata e parë mbi legjislacionin kombëtar dhe atë të BE-së për çështjet e mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve. Kjo ligjeratë u ndjek nga 32 pjesëmarrës të cilët kishin mundësi të përmirësonin njohuritë e tyre mbi legjislacionin kombëtar dhe atë të BE-së mbi çështjet e mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Ligjerata kishte si qëllim edhe të inkurajonte shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet dy bashkive/komunave bashkëpunuese në projekt dhe të ofrojë informacion të rëndësishëm dhe sugjerime mbi

menaxhimin e mbetjeve, mbrotjen e mjedisit sipas standardit kombëtare dhe atij të BE-së, për ato institucione që janë përgjegjëse për mbledhjen dhe menaxhimin e mbetjeve në territoret e tyre. Takimi i dytë do të mbahet në Shkodër, gjatë muajit shtator.

Rritja e ndërgjegjsimit të popullatës në zonën ndërkufitare mbi rrezikun dhe mbrojtjen nga përmbytjet

Si pjesë e projektit "Fatqësitë nuk njohin kufinj", organizata FORS Montenegro në bashkpunim me Drejtorinë për emergjencat në Ministrinë e Brendshme të Malit të Zi dhe Prefekturën Shkodër kanë realizuar pothuajse të gjitha aktivitetet e parashikuara të projektit 18 mujor. Pas takimeve, trajnimeve dhe punëtorive të organizuara, pritet që shumë shpejt pajisje të reja për mbrojtjen dhe shpëtimin nga përmbytjet do blihen dhe ti jepen për përdorim strukturave të specializuara. Në përputhje të plote me këtë, një set pajisjesh për parashikimin e motit dhe paralajmërimin e hershëm ju dhurua autoriteteve kompetente në Malin e Zi.




Gjithashtu duke patur në konsideratë rritjen e ndërgjegjsimit të popullsisë për mbrojtjen dhe shpëtimin nga përmbytjet dhe menaxhimin e riskut të fatqësive, partnerët e projektit organizuan disa fushata promovuese, saktësisht 17 ligjerata me nxënës me temë Reduktimi i Rrezikut nga Dizastrat dhe 7 punëtori me temë Mbrojtja nga Përmbytjet me komunitetin lokal. Përveç këtyre, fushata promovuese përfshiu edhe konferenca, emisione në radio dhe TV, artikuj në gazeta dhe website si dhe shpërndarje të broshurave dhe fletpalosjeve.



Modelimi i brendshëm i shtëpive rurale në Malin e Zi

Gjatë periudhës maj-gusht të vitit 2019, partnerët e projektit "Ruatja e Peisazhit Kulturorë" organizuan fushatë në terren për të identifikuar shtëpitë dhe mundësitë e përshtatjes së tyre me peisazhin kulturorë të zonës ndërkufitare.

Ky aktivitet që parashikon dekorimin e brendshëm të shtëpive në përputhje me traditën dhe ambientin, përfshiu 10 shtëpi nga komunat e Beranes, Petnjicës, Andrijevicës, Plavës and Gucisë. Shtëpите ndodhen në fshatrat Konjuhë dhe Kralje të Komunës së Andrijevicë, fshati Grebaje në Guci, etc. Elementë tradicional, punime dore dhe objekte të bëra me material natyrorë ishin në fokus të këtyre aktivitetëve.



Panairi i Mjadrës u organizua në Petnicë

Bashkia e Petnicës, Organizata e Kombëtare e Prodhuesve të Manaferrave, shkolla e mesme e Petnjicës, shkolla e mesme Profesionale "Ndre Mjeda" dhe OJF COSPE Shqipëri, si partnerë në projektin "Të Rinjtë Malazet dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës" organizuan një sërë punëtorish për prodhuesit lokal të Mjadrës.

Saktësisht, 9 punëtori u organizuan në Bushat (Bashkia Vau i Dejës, Shqipëri), dhe 8 në Petnjicë (Mal i Zi). Ekspertët e prodhimit të mjadrës që drejtuan punëtorit ishin Nebojsa Veličković, Adis Ličina dhe Ivona Joçiq.



Sajam malina kao ključna aktivnost održan je 26. jula 2019. godine u Petnjici i organizovan je na platou ispred opštine Petnjica.

Panairi i Mjadrës si një aktivitet kyç i këtij projekti u mbajt në Petnjicë me 26 Korrik të vitit 2019 në sheshin përpara komunës. Përfaqësuesit e të gjithë partnerëve të projektit nga Mali i Zi dhe Shqipëria ishin prezent në panair, ndërsa menaxheri i projektit Ismet Latiq, drejtori i shkollës profesionale "Ndre Mjeda" Ruzhdi Kapidanja, dhe nën-kryetari i Komunës së Petnjicës Muslija Kaliq, përshendetën të pranishmit në këtë event.

Tek standat e panairit, përfutuesit e projektit patën rastin të prezantojnë dhe promovojnë produktet e tyre, ndërsa pjesëmarrësit në panair patën mundësinë të shijojnë produktet e mjadrës të kultivuar nga fermerët e Petnjicës, zonave përreth dhe disa fermerëve nga Shqipëria. Përveç

këtyre, Shkolla Profesionale e Petnjicës dhe Organizata turistike lokale prezantuan produktet dhe ofertat e tyre në panair.



Të drejtat e fëmijëve të përfshihen në procesin e vendim-marrjes

Shoqata për Prosperitet Demokratik – ZID në bashkpunim me Qendrën Fëmijët Sot nga Shqipëria organizuan punëtorinë e parë për shkëmbimin e eksperiencave në të cilën pjesëmarrësit patën mundësi të marrin më shumë informacion mbi planifikimin e produkteve turistike, shitjet, marketingun, promovimin dhe partneritetin në sektorin e turizmit. Gjithashtu një takim për ndërtimin e rrjetit të organizatave u mbajt dhe bëri bashkë ekspertë të fushës së turizmit, përfaqësues të organizatave turistike, agjensitë turistike dhe shoqërinë civile me qëllim inkurajimin e zhvillimit të bashkpunimit në rajon nëpërmjet paketave të përbashkëta të ofertave turistike në zonat kufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë. Për më tepër, në fillim të vitit u organizuan një sërë trajnimesh modulare me qëllim promovimin e produkteve të përbashkëta.



Punëtorinë e dytë rajonale në kaudër të këtij projekti u mbajt në Lezhë, në datat 21-23 qershor të vitit 2019. Në këtë takim pjesëmarrësit patën rastin të mësonin mbi të drejtat e fëmijëve dhe rëndësinë e konsiderimit të tyre gjatë proceseve vendim-marrëse. Po ashtu pjesëmarrësit patën rastin të mësojnë mbi inovacionet e qëndrueshme

në turizëm dhe catering, karakteristikat e turizmit miqësorë për fëmijët, mundësitë e tregut turistik miqësorë me fëmijët, standartet dhe kërkesat e tregut.

Gastronomia në rajonin e BNK

Në përpjekje për të krijuar një ofertë turistike në zonën ndër-kufitare të bazuar tek gastronomia, u zbuluan dhe standardizuan 45 reçeta të vjetra tradicionale për përdorim nga hotelet dhe restorantet e zonës, në kuadër të projektit "Kuzhina Lokale si ofertë turistike". Si rezultat i aktiviteteve të zbatuara deri tani, Rruga e Mjalit dhe Rruga e Embëlsirave janë finalizuar si rrugë turistike, ndërkohë që familjet lokale kanë marrë pjesë në trajnime të dedikuara.

Zona për të shijuar produktet brenda familjeve të përzgjedhura po ndërtohen. Gjithashtu dizajni i menuve dhe tabelave identifikuese është kompletuar si pjesë e aktiviteteve për markimin e bizneseve, përfshirë emrin e markës dhe logon. Në periudhën në vijim pritet që të prezantohet në publik libri i kuzhinës me gatime tradicionale për publikun e gjerë.

U zbuluan gërmadhat e të ashtëquajturës Qyteti Tumba

Rezultati i parë i projektit "Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit" u prezantua zyrtarisht në një konferencë mediatike mbajtur me datë 4 qershor të vitit 2019 në fshatin Donja Rzhanica në Berane.

Gjatë kësaj konference, ekipi i projektit prezantoi gjetjet arkeologjike të zbuluara gjatë gërmimeve të qytetit të ashtëquajtur Tumba si një thesar i paçmuar arkeologjik. Pjesëmarrësit dëgjuan fjalën e këshilltarit të kryetarit të komunës së Beranes, Darko Stojanoviq, drejtoreshës së Muzeut Polimje Violeta Foliq, dhjakut Konstantin Dojiq, që është njëkohsisht edhe drejtues i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Sanja Todoroviq drejtuese e SPT-së.



1



1a



2

Për më tepër, Predrag Lutovac arkeologu i muzeut Polimje prezantoi aktivitetet kryesore, kurse Milija Pantoviq, foli për sitet arkeologjike.

Deri tani dy faza të kerkimit arkeologjik janë kryer në këtë zonë. Në fazën e parë, një ekip ekspert me 5 anëtarë dhe 15 gërmues manual kryen kërkimet mbi ruatjen dhe gërmimet arkeologjike. Në fazën e dytë u punua në shëtitoren kryesore të qytetit. Gjatë kërkimit arkeologjik u gjetën shumë materiale arkeologjike të lëvizshme.

Fakte – Qyteti TUMBA

“Gjatë kërkimit arkeologjik gjetem mjaft materiale të levizshme. Numri më i madh i gjetjeve ishin tri koka shigjete, thika hekuri të vogla dhe të mëdha, mjete dekoruese, lloje te ndryshme pykash, një tjetër grup gjetjesh konsiston në deposita monedhash, unazash, karficash dhe tufa rripash që përcaktojnë qartësisht kohën e ngritjes dhe rënies së qyteterimit të kësaj qendre urbane -” –Muzeu Polimje



Punëtori për inovacionin social dhe punën online

Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e I-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

Punëtori mbi menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve

Ekipi i projektit “Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave” organizoi një event për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të kompanisë së mirëmbajtjes. Punëtorja dy-ditore u mbajt në Plavë në datat 15 - 16 gusht të vitit 2019 dhe aty morën pjesë 46 punonjës nga dy ndërmarrjet komunale, përfaqësues të komunave, përfaqësues nga policia komunave dhe inspektorët e mjedisit si dhe qytetarë nga komunat Plavë, Guci dhe Murino.



Pjesëmarrësit patën rastin të marrin njohuri mbi menxhimin e integruar të mbetjeve, si p.sh. seleksionimi natyror si baza për të prezantuar komunitetin me menaxhimin dhe kontrollimin e integruar të mbetjeve. Punëtori të ngjashme do vazhdojnë të organizohen në kopështe, shkolla fillore dhe shkolla të mesme. Për më tepër pritet të fillojë së shpejti procesi i ndërtimit të fushës së riciklimit dhe depozitimit të mbetjeve.

Fushata promovionale për promovimin e konceptit të inovacionit social dhe metodat e punësimit on-line si mundësi profesionale janë inicuar në kuadër të projektit “Vet-punësimi i të rinjve dhe ndërmarrjet sociale”.

Gjatë periudhës 10-11 korrik të vitit 2019 janë organizuar gjashtë punëtori për gjashtë komunat e targetuara të projektit në Berane, Rozhajë dhe Podgoricë. Punëtori të ngjashme u mbajtën edhe në Kosovë në datat 10-12 korrik të vitit 2019 në komunën e Pejës, Istogut dhe Deçanit. Saktësisht gjatë kësaj periudhe 76 pjesëmarrës nga Mali i Zi dhe Kosova patën rastin të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të mësojnë më shumë mbi mjetet dhe praktikat e lidhura me inovacionin social dhe punën online.



Ndërkohë punëtoritë shërbyen si bazë për mbledhjen e të dhënave për trajnimet e nevojshme, dizajnimin e trajnimeve, kurrikulave dhe materialeve përkatëse.

Hartëzimi i resurseve agrikulurore

Partnerët e projektit "Punë në sektorin bujqësor për një të ardhme më të mirë të rajonit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Kosovës", i udhehequr nga komuna e Andrijevicës, realizuan hartëzimin e resurseve agrikulurore në bashkitë e targeturara në Malin e Zi dhe Kosovë. Gjithashtu u realizua edhe promovimi i punësimit në sektorin e bujqësor dhe kjo iniciativë do vazhdojë edhe më tej, fokusuar veçanërisht tek shkollat e mesme nëpërmjet agjencive të punësimit në Berane, Andrijevicë, Plavë dhe Deçan. Në lidhje me u realizuan edhe intervista me fermeret mbi temën e projektit.



Përmirësimi i shërbimeve shëndetsore

Në kuadër të projektit CARES – Veprimet ndër-kufitare në Sektorin e Shëndetit Riprodhues, organizata FORS Montenegro bëri një studim ([Survey on knowledge and habits](#)) në lidhje me shëndetin riprodhues në muajin maj dhe qershor të vitit 2019. Qëllimi i këtij studimi ishte të mbledh informacion nga opinion publik mbi njohuritë e grave për këtë temë, ndërgjegjësimit e tyre mbi rëndësinë e veprimeve parandaluese dhe sjelljet e grave në lidhje me temat e projektit. Në studim u përfshinë 1.104 persona nga komunat e Bijello Poles, Beranes, Plavës, Rozhajës, Mojkovacit, Kolashinit, Andrijevicës, Gucisë dhe Petnjicës. Studimi tregoi që të intervistuarit ishin të mirëinformuar mbi çështjet e shëndetit riprodhues, por 44% e tyre nuk kanë patur asnjëherë një egzaminim parandalues. Siç konfirmohet nga studimi ka një risk të madh në këto zona për kancerin e gjirit dhe atë të qafës së mitrës.

Për këtë arsye në periudhën në vazhdim, muaji Tetor do shpallet si muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit dhe një fushatë për egzaminimin parandalues do organizohet për gratë e zonës. Fushata do organizohet bashkërisht me qendrat shëndetsore dhe institucione të tjera që do mund të ndihmojnë në mobilizimin e grave, siç janë mediat, autoritet lokale, kompanitë, shoqëria civile, etj.



Nadi vremena. Spriječi. Živi.

Aktivitetet Eko-turistike dhe natyrore në Alpet e Ballkanit

Projekti „Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike“ po zbatohet nga qendra për Mbrotjen dhe Hulimtimin e Zogjve, Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim KADC, Shërbimi i Shpëtimit Malor të Malit të Zi, dhe shoqata e alpinistëve „PASHTRIKU“. Gjatë fazës fillestare të zbatimit të projektit, u organizuan aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Më saktë, trajnimi “Në vazhden e banorëve të pyjeve” u mbajt nga data 26 deri me 28 qershor të vitit 2019, ku guidat dhe operatorët turistike nga Mali i Zi dhe Kosova punuan sëbashku në zonën e Bjeshkëve të nemuna dhe patën rastin të mësojnë më shumë rreth gjitarëve të mëdhenj, zogjve dhe kërpudhave, në mënyrë që ta përcjellin këtë informacion tek turistët dhe t’a prezantojnë zonën në termat e pasurisë së biodiversitetit.



Ngritja e kapaciteteve do vazhdojë me një punëtori të përbashkët për krijimin e integruar dhe koherent të një paketë turistike mbi destinacionin e Alpeve Ballkanike. Përveç produktit të ri turistik, periodha në vijim parashikon ndërhyrje të vogla infrastrukturore që do rrisin elementët e sigurisë për vizitorët e zonës. Për këtë arsye gjatë muajit tetor do bëhet riparimi i shtigjeve turistike. Gjithashtu trajnime të specializuara për guidat alpine do të organizohen në muajt në vijim.



Mbani ambientin e pastër dhe të gjelbër - të bashkuar kundër ndotjes

Projekti ndërkufitar "Të Bashkuar kundër Ndotjes" u prezantua gjatë një konference që u mbajt në Gjakovë me datë 27 qershor të vitit 2019. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues nga përfuturit e projektit, kryetarët e komunave, zyrtarë të komunave, shoqëria civile dhe media.



Gjatë konferencës u theksua që ky projekt do fuqizojë komunitetet dhe komunat partnere që të përfshihen më shumë në çështjet e mbrotjes së mjedisit, adaptimit dhe zbutjes së efekteve të ndryshimit të klimës, parandalimit të riskut të ndotjes së mjedisit dhe menxhimi i mirë i mbetjeve. Gjithashtu u theksua që një ndër qëllimet e projektit është edhe ndërgjegjësimi i popullsisë për çështjet e ndotjes, mjedisit dhe mbrotjes së tij.



Në periudhën fillestare të këtij projektit, u realizua dialogu me autoritetet lokale, të rinjtë, nxënësit dhe komunitetit mbi çështjet e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm duke bërë në këtë mënyrë edhe një hartëzim të aktoreve relevant. Ekipi i projektit ka bërë edhe një raport të hollësishëm përfshi edhe një hartë të fushë depozitimeve ilegale të mbetjeve me kordinata të sakta gjeografike dhe madhësitë repsektive.

Bjeshkët e Nemura - destinacion natyrore tërheqës

Brenda këtij projekti që udhëhiqet nga Agjencia për zhvillim Rajonal Bjelasica, Komovi dhe Prokletije (BKP) nga Mali i Zi, gjatë fazës fillestare të projektit u punua në mbledhjen e informacionit mbi rrejtin e shtigjeve ekzistuese dhe më pas filluan punën për të zhvilluar propozime për krijimin e shtigjeve të reja që do të mund të sigurojnë lidhje me të mirë të rajonit. Në mënyrë që të përmirsohet oferta turistike u mbajtën edhe një sërë takimesh me aktoret e rëndësishëm lokal dhe më gjërë.


Takimi i tetë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt në Plavë

Takimi i tetë i Komitetit të Përbashkët të Projektit u mbajt me 31 korrik të vitit 2019 në Plavë (Mal i Zi). Gjatë takimit u diskutua mbi zbatimin dhe mbi aktivitetet e ardhshme gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 në kuadër të IPA Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë 2014-2020.

Në takim morrën pjesë përfaqësuesit e Zyrës për integritet evropian të Malit të Zi, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi, Ministrisë së Financave të Malit të Zi – Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Asistencës së BE-së (CFCU), Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë si dhe të Sekretariatit të Përbashkët Teknik të IPA programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mali i Zi-Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë 2014 – 2020.



o ashtu, anëtarët e Komitetit të Përbashkët të Projektit kanë vizituar projektin "Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave" në Plavë, financuar në kuadër të Thirrjes së parë të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë 2014-2020. Projekti zbatohet nga Kompania e Sherbimeve Komunale Plavë dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave "Çabrat" nga Gjakova. Gjatë vizitës anëtarët e Komitetit të Përbashkët të Projektit u informuan për aktivitetet e zhvilluara dhe të ardhshme në kuadër të projektit.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



European Integration Office



Ministry of finance
Directorate for Finance and Contracting
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

Sanja TODOROVIC

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik
E-mail: sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Maja RADOVIC

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat
E-mail: maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Nikola DJONOVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në Komunikim
E-mail: nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Almir CAUSEVIC

Zyrtar Projekti me Specializim në IT
E-mail: almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org

Petar BELADA

Asistent Administrativ
E-mail: petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Andi ÇEKAJ

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**
Adresa: Agim Ramadani, 36/4, 10 000 Prishtinë, Kosova
Telefon: +383 38 222 202

Gazmir RACI

Zyrtar Projekti, Antenë
E-mail: gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org

www.cbc-mne-alb.org | www.cbc-mne-kos.org



Ky projekt është i financuar
nga Bashkimi Evropian